

Informacion kryesor për investitorin

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid dhe nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me Ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në Fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo në këtë Fond.

FONDI I QËNDRUESHËM RAIFFEISEN SOLID (në vijim: Fondi Furnizues)

është Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike në tituj të transferueshëm, me pjesëmarrje të hapur, i krijuar si Fond Furnizues nga Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a., me seli në Rr.Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Tiranë, Shqipëri.

Fondi Kryesor është Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide, i cili administrohet nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., me seli në Mooslackengasse 12, A-1190 Vienë, Austri.

Kuotat e Fondit Furnizues nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid nuk është një investim i garantuar, Fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe risku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

➤ Objektivat dhe Politika e investimit*

Objektivi i Fondit Furnizues është t'ju mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide, i cili synon krijimin e të ardhurave të rregullta në një periudhë afatmesme.

Fondi Furnizues investon në kuotat e Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide të paktën 85% te aseteve dhe jo më shumë se 15% të aseteve në instrumente si depozita bankare afatshkurta, marrëveshje të riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes, cash apo ekuivalentë të tij.

Fondi Kryesor është një Fond miqs që investon në tituj, emetuesit e të cilëve janë klasifikuar si të qëndrueshëm në bazë të kritereve sociale, mjedisore dhe të qeverisjes (pa marrë parasysh investimet në fonde investimi, instrumentet derivative dhe depozitat). Sipas këtyre kritereve, nuk investohet në sektorë të caktuar të tillë si armatimi ose inxhinieria gjenetike e gjelbër/bimëve, në kompanitë që shkelin të drejtat e punës dhe të njeriut ose janë të përfshira në korrupsion dhe manipulim të pasqyrave financiare si dhe në shtete që kanë regjime autoritare, shkelin lirinë e medias e shtypit, nuk janë pjesë e marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike apo kanë problematika të lidhura me pastrimin e parave. Fondi Kryesor e ka kufizuar investimin në aksione deri në 30% të aseteve të tij. Të paktën 51% e aseteve të Fondit Kryesor investohen drejtpërdrejt në tituj. Emetuesit e obligacioneve ose instrumenteve të tregut të parash në Fond mund të jenë, ndër të tjera, shtetet, organizatat supra kombëtare dhe/ose kompanitë. Fondi Kryesor mund të investojë më shumë se 35% të aseteve në tituj borxhi të emetuar nga qeveria e Austrisë, Gjermanisë, Belgjikës, Finlandës, Francës ose Holandës. Fondi Kryesor menaxhohet në mënyrë aktive pa iu referuar ndonjë standardi (benchmark). Fondi Kryesor mund të investojë në instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit, me qëllimin për të zbutur risqet dhe për të arritur objektivat e politikës së investimit.

Të ardhurat e Fondit Furnizues nuk shpërndahen por ri-investohen. Monedha bazë e Fondit Furnizues është Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro. Shitja e kuotave të Fondit Furnizues mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij. Shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga dita e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Performanca e Fondit furnizues do të varet ndjeshëm nga performanca e Fondit Kryesor, e cila mund të luhatet në varësi të kushteve të tregut. Kostot e transaksioneve nuk kanë një ndikim material mbi performancën e Fondit.

Rekomandim

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët të cilët planifikojnë të tërhiqen nga Fondi brenda afatit 5 vjeçar. Duke patur parasysh natyrën e investimeve me luhatshmëri të lartë siç janë aksionet, ky horizont do të rriste mundësinë për një kthim optimal nga investimi. Fondi Furnizues nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatmesme dhe afatgjatë pasi qëndrimi shumë i shkurtër në Fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

*Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid.

➤ Profili i risk dhe përfitimit

Risk i ulët

Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë

Potencial Përfitimi më i lartë

1	2	3	4	5	6	7

- Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së Fondit bazuar në historikun e performancës. Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur Fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë.
- Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës.
- Profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues është i lidhur ngushtë me profilin e riskut të Fondit Kryesor.
- Bazuar në të dhënat historike të kthimeve të Fondit Kryesor gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të Fondit Furnizues i përket kategorisë 3 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRRI=3).

Risqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulohen tërësisht nga treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit:

Risku i kreditit: ky risk lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar, pjesë e asetëve të Fondit Kryesor, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e asetëve të Fondit Furnizues

Risku i likuiditetit: risku që Fondi Furnizues të gjendet në pamundësi për të shitur kuotat e Fondit Kryesor për shkak të pezullimit të aktivitetit nga ana e këtij të fundit.

Risk i palës tjetër: risku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Gjithashtu ky risk lidhet me mundësinë që pala tjetër të mos jetë në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.

Risku operacional: risku i humbjeve të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërive administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e marketingut, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondeve

Risqet që rrjedhin nga përdorimi i derivateve: Fondi Kryesor mund të përdorë instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit. Kjo rrit riskun e luhatjes së vlerës së Fondit Kryesor dhe për pasojë edhe të Fondit Furnizues.

Komisionet dhe tarifat

Komisionet dhe tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Këto komisione dhe tarifa zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.

Komisione/tarifa të njehershme përpara ose pas investimit	
Komisioni/tarifa e hyrjes	0.00%
Komisioni/tarifa e largimit	1.00% e vlerës së kuotave të shitura për çdo shitje të kryer përpara 2 vjetësh nga investimi në Fond
Komisione/tarifa të vazhdueshme që mbahen gjatë 1 viti	
Nuk ka të dhëna	
<p>Shifra e tarifës së vazhdueshme mbështetet në shpenzimet për vitin paraardhës.</p> <p>Tarifa e vazhdueshme përfshin tarifën e administrimit, e cila është deri në 1.30% në vit dhe çdo tarifë të vendosur gjatë vitit të shkuar. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifat e vazhdueshme që paguhen nga asetet e Fondit në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë 3.50% në vit të vlerës neto të asetëve të Fondit. Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit. Lutemi referojuni zërit "Shpenzime" të raportit vjetor të Fondit për detaje të mëtejshme lidhur me komponentët e tarifës së vazhdueshme. Për më tepër informacion rreth kostove/tarifave, jeni të lutur ti referoheni seksionit 3.15 të prospektit të Fondit të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese: www.raiffeisen-invest.al.</p>	
Komisione/tarifa të veçanta	
Komisioni/tarifa e Performancës	E paaplikueshme

Paraqitja e performancës së shkuar

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid ka filluar aktivitetin më 07 Maj 2024 dhe nuk ka të dhëna mbi performancën e shkuar të tij.

Informacione praktike

- Banka Depozitare është Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, si dhe pranë degëve të Raiffeisen Bank sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit Kryesor mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese të Fondit Kryesor: www.rcm.ataiffeisen-invest.al, si dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese të Fondit Furnizues: www.raiffeisen-invest.al.
- Çmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- Raiffeisen INVEST sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit të fondit.

Fondi Furnizues i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid është i licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raiffeisen INVEST sh.a është e licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Fondi Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide është i licencuar në Republikën e Austrisë nga Autoriteti Austriak i Tregjeve Financiare dhe administrohet nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., e licencuar nga ky Autoritet.

Ky dokument me informacionin Kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 07 Maj 2024.